

# **Plani Strategjik Trevjeçar i Këshillit të Prindërve të Shkollës Mileniumi i Tretë 2022/23 – 2024/25**


## **VIZIONI**

**“Ta avancojmë KPSH-në në forum të qasshme dhe efektive që inkurajon dhe mundëson angazhimin dhe pjesëmarrjen e prindërve si dhe vepron si urrëlidhëse me shkollën në të mirë të fëmijëve”**

## **MISIONI**

**“Të punojmë me përkushtim për të përmbushur potencialin akademik dhe zhvillimor të fëmijeve në bashkëpunim dhe në komunikim të vazhdueshëm me prindëritë dhe shkollën”**

# QËLLIMET STRATEGJIKE



## Qëllimet strategjike 2022/23-2024/25

Qëllimi i Parë Strategjik: „Avancimi i vazhdueshëm i urrës komunikuese dhe bashkëveprimit në mes të KPSH, prindërve dhe shkollës“.

**Progresi i deritanishëm:** Nga viti 2016 KPSH ka bërë progres të kënaqshëm në organizimin e brendshëm që ka mundur punën në grupe të punës për të shqyrtuar tema specifike si psh. cilësia akademike, e ushqimit, etj. Këto forume të punës janë quajtur Komitete të cilat kanë rregulluar punën e tyre përmes termave të referencës. Fillimisht janë themeluar pesë komitete me përgjegjësitë e cekura në vijim:

1. Komiteti për Cilësi Akademike
2. Komiteti për Shëndet dhe Siguri
3. Komiteti për Cilësi të ushqimit
4. Komiteti për Organizime të ngjarjeve
5. Komiteti për Komunikim dhe promovim të KPSH

Nga komitetet e lartpërmendura, Komiteti për Komunikim dhe promovim të KPSHë shuar, ndërsa komitetet tjera janë funksionale me anëtarë dhe kryesues. Pandemia ka qënë pengesa kryesore e progresit në punën e komiteteve nga viti 2020.

**Avancimi organizativ i KPSH:** Për arritjen e këtij qëllimi, KPSH do të vazhdoj me avancimin e organizimit formal duke komunikuar dhe bashkëvepruar me shkollën përmes komiteteve të punës që do të adresojnë kërkesat e prindërve por edhe të shkollës dhe të komunikohen anasjelltas, në formë të rekomandimeve. KPSH do të zotohet për qëllime vjetore dhe aktivitete përcjellëse dhe do të themeloj protokolle të llogaridhënies dhe vlerësimit të performancës. KPSH kryesisht do të organizon punën e saj përmes Komiteteve të përhershme të punës për çeshtje të natyrave standarde dhe aktiviteteve vjetore, dhe Komiteteve ad-hoc për çeshtje specifike. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve janë të definuara në terma të references të miratuara nga KPSH të cilat do të shqyrtohen së paku në baza tre-vjecare.

Per periudhen e planifikimit strategjik, KPSH do te organizoj punen e saj permes komiteteve te mëposhtme ku propozohet që me vendim të KPSH të rithemelohe Komiteti per Komunikim dhe promovim te KPSH:

1. Komiteti për Cilësi Akademike

2. Komiteti për Shëndet dhe Siguri
3. Komiteti për Cilësi të ushqimit
4. Komiteti për Organizime të ngjarjeve
5. Komiteti për Komunikim dhe promovim të KPSH

Rolet e Komiteteve janë si në vijim:

Roli i Komitetit për Cilësi Akademike është të mundësoj pjesëmarrjen aktive të prindërve në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke identifikuar dhe trajtuar të gjitha çështjet që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve më të mira.

Roli i Komiteti për Shëndet dhe Siguri ka për qëllim të ndihmojë shkollën në ofrimin e një ambienti të sigurtë dhe të shëndetshëm për nxënësit dhe stafin e shkollës, përmes zhvillimit të protokolleve të aplikueshme në fushën e shëndetit dhe sigurisë.

Roli i Komiteti për Cilësi të ushqimit ndihmon shkollën në aktivitetin e saj të ofrimit të ushqimit me cilësi të mirë, të shëndetshëm – me vlera ushqyese që përmbushin standarde, të ekuilibruar dhe me porcione konform moshës, i përgatitur dhe i gatuar profesionalisht, nga përbërës të freskët dhe të shërbehet në një ambient që plotëson standardet higjienike dhe të hapersirës. Qëllim i mëtutjeshëm është që të ndihmohet në zhvillimin e shprehive dhe të edukatës së të ushqyeritë të shëndetshëm.

Roli i Komitetit për Organizim të ngjarjeve është të bashkëveprojë me shkollën për organizim të ngjarjeve të ndryshme me tema të ndryshme si: bamirësie, edukative, festive, familjare, rrjetizim, vetëdijësuese, etj.

Roli i Komiteti për Komunikim dhe promovim të KPSH është të ngrit vetëdijen e prindërve dhe shkollës për veprimtarinë e KPSH, aktivitetet dhe progresin, në mënyrë që të nxit kontributin e prindërve dhe progresin e tërë komunitetit shkollor – prindër, nxënës, shkollë.

Në shtesë, KPSH që në vitin e parë të planifikimit strategjik do të filloj angazhimin në riorganizim të punës duke adoptuar teknologjinë më të përshtatshme për të përmbushur objektivat sikurse (i) puna dhe bashkëveprimi “online” i Kryesise dhe komiteteve përkatëse; (ii) arkivimi i punës së KPSH dhe komiteteve përkatëse që do të mundësoj mbajtjen dhe transferimin e njohurive ndërmjet anëtarësisë; (iii) pasqyrimi i punës së KPSH në platforma online të qasshme për prindëritë dhe publikun e gjerë.

Viti	Aktiviteti	Përgjegjësitë
2022/2023	<p>1. Vlerësimi dhe planifikimi i riorganizimit të punës së KPSH bazuar në teknologji që të mundësoj punën dhe bashkëpunimin online dhe siguroj eficiencë dhe rezultate; historikun mbi punën e KPSH-së që do të mundësoj menaxhimin dhe mbatjen e njohurive; – si dhe të mundësoj pasqyrimin e punës së KPSH në platforma të qasshme për prindëritë.</p> <p>2. Shqyrtimi funksional i komiteteve për nga roli, mandati dhe anëtarësia; përfshirë shqyrtimin e termave të referencës nga Komitetet funksionale dhe miratimi i tyre nga KPSH.</p> <p>3. Hartimi i planeve trevjecare të punës së komiteteve.</p> <p>4. Përbushja e një aktiviteti nga secili Komitet dhe raportimi në KPSH.</p>	<p>Kryesia e KPSH-së në bashkëpunim me shkollën</p> <p>Komitetet përkatëse në bashkëpunim me Kryesinë</p> <p>Komitetet përkatëse</p> <p>Komitetet përkatëse</p>
2023/2024	<p>1. Zbatimi i riorganizimit të punës së KPSH bazuar në teknologji që të mundësoj punën dhe bashkëpunimin online dhe siguroj eficiencë dhe rezultate.</p> <p>2. Përbushja e një aktiviteti nga secili Komitet dhe raportimi në KPSH</p>	<p>Kryesia e KPSH-së në bashkëpunim me shkollën</p> <p>Komitetet përkatëse</p>
2024/2025	<p>1. Zbatimi i riorganizimit të punës së KPSH bazuar në teknologji që të mundësoj punën dhe bashkëpunimin online dhe siguroj eficiencë dhe rezultate.</p> <p>2. Përbushja e një aktiviteti nga secili Komitet dhe raportimi në KPSH</p>	<p>Kryesia e KPSH-së në bashkëpunim me shkollën</p> <p>Komitetet përkatëse</p>

Qëllimi i Dytë Strategjik: “Mbështet prindëritë e shkolles Mileniumit të Tretë duke inspiruar dhe fasiluar mundësitë për t’u njohur me filozofinë e të mësuaritë në shkollë”

**Progresi i deritanishëm:** KPSH ka ftuar në baza të rregullta Drejtorinë për njoftim të KPSH mbi të arriturat e shkollës për periudha të ndryshme dhe njëkohësisht ka ofruar forum për prindëritë përfaqësues të ngrisin ceshtje të ndryshme. Progresi në përmbushje të këtij qëllimi ishte i mangët për shkak të shuarjes së komitetit dhe të fillimit të pandemisë.

Për të adresuar këtë qëllim neve duhet ti kuptojmë dhe ti evidentojmë fushat e interesimit të prindërve, kërkesat, pyetjet dhe brengat, dhe të punojmë ngushtë me shkollën për të themeluar kanale të komunikimit që janë te qëndrueshme dhe me kosto efektive. KPSH do të fton menaxhmentin e shkollës për prezantim për tema të veçanta (iniciativa, raport për progresin, etj) në çdo takim të KPSH. Sa më shumë të ngritën njohuritë e prindërve për punën e shkollës, aq më shumë prindëritë mund ta ndihmojnë fëmiun e tyre, mësuesitë (arsimtarët)/kujdestarën, shkollën dhe tërë komunitetin.

Komiteti për Komunikim dhe Promovim të KPSH do të angazhohet për anketim të prindërve dhe do të përpilon listën e përgjigjeve në pyetjet më të shpeshta dhe do të evidenton prindër të vullnetshëm si mentor për prindër fëmijët e të cilëve sapo janë regjistruar në shkollë. Komiteti për Komunikim dhe Promovim do të harton programin e mentorimit dhe të dizajnon çmime për prindër te cilët me kontributin e tyre kanë shtuar vlerë në punën e KPSH-së.

Në bashkëpunim me shkollën ndërmerr hartimin e udhëzuesitë për prindër dhe nxënësitë për tju ndihmuar integrimin për fillestaret dhe bashkëpunimin për ekzistuesitë. Udhëzuesi shtjellon informata të cilat janë relevante për prindër dhe nxënësitë, në mënyrë që të ngrisin njohuritë mbi funksionimin e shkollës dhe punën e saj.

Viti	Aktiviteti	Përgjegjësitë
2022/2023	Harton planin trevjeçar të punës që do të siguroj përmbushjen e qëllimit strategjik duke (i) evidentuar fushat e interesimit të prindërve, kërkesat, pyetjet dhe brengat; (ii) evidentimin e kanaleve të komunikimit që	Komiteti për Komunikim dhe Promovim

	<p>janë te qëndrueshme dhe me kosto efektive; (iii) evidenton prindërite e vullnetshëm si mentor për prindër fëmijët e të cilëve sapo janë regjistruar në shkollë; (iv) dizajnon çmime për prindër te cilët me kontributin e tyre kanë shtuar vlerë në punën e KPSH-së.</p> <p>Ndan cmime për prindërite të cilët me kontributin e tyre kanë shtuar vlerë në punën e KPSH-së.</p>	
2023/2024	<p>Zbaton programin e mentorimit për prindëritë, fëmijët e të cilëve sapo janë regjistruar në shkollë për të ndihmuar gjithpërfshirjen dhe përmbushjen e potencialit zhvillimor dhe akademik të fëmiut (ky program mund të zbatohet edhe për prindër ekzistues duke ndihmuar në sfida përgjatë shkollimit)</p> <p>Ndan cmime për prindëritë të cilët me kontributin e tyre kanë shtuar vlerë në punën e KPSH-së.</p>	Komiteti për Komunikim dhe Promovim
2024/2025	<p>Zbaton programin e mentorimit për prindërite, fëmijët e të cilëve sapo janë regjistruar në shkollë për të ndihmuar gjithpërfshirjen dhe përmbushjen e potencialit zhvillimor dhe akademik të femiut (ky program mund të zbatohet edhe për prindër ekzistues duke ndihmuar në sfida përgjatë shkollimit)</p> <p>Ndan cmime për prindërite të cilët me kontributin e tyre kanë shtuar vlerë në punën e KPSH-së.</p>	Komiteti për Komunikim dhe Promovim

Qëllimi i Tretë Strategjik: Organizon dhe shfrytëzon vullnetin dhe energjinë e prindërve dhe KPSH për të iniciuar dhe mbështetur ngjarje/organizime që pasurojnë jetën shkollore.

Objektivi ynë është të bashkëveprojmë me shkollën në organizim të ngjarjeve me tema të ndryshme si: bamirësie, edukative, festive, familjare, rrjetizim, vetëdijësuese, etj. Roli i Komitetit për Organizim të ngjarjeve është të bashkëveprojë me shkollën për organizim të ngjarjeve të ndryshme.

Viti	Aktiviteti	Pergjegjesite
2022/2023	<p>1. Harton planin trevjecar të punës së Komitetit duke evidentuar në bashkëpunim me Shkollën së paku një organizim të përbashkët me tema të ndryshme si: bamirësie, edukative, rrjetizim, vetëdijësuese, etj. që do të siguroj përmbushjen e qëllimit strategjik</p> <p>2. Organizon së paku një aktivitet me Shkollën mbi temat e evidentuara apo aktuale të kohës</p>	<p>Komitetit për Organizim të ngjarjeve</p> <p>Komitetit për Organizim të ngjarjeve</p>
2023/2024	<p>1. Organizon së paku një aktivitet me Shkollën mbi temat e evidentuara apo aktuale të kohës</p>	<p>Komitetit për Organizim të ngjarjeve</p>
2024/2025	<p>1. Organizon së paku një aktivitet me Shkollën mbi temat e evidentuara apo aktuale të kohës</p>	<p>Komitetit për Organizim të ngjarjeve</p>

Qëllimi i Katërt Strategjik: “Evidenton ekspertizën e prindërve për të mbështetur më mirë shkollën”

Objektivi ynë është që të themelojmë një databazë të aftësive/ekspertizës së prindërve, përmes së cilës do të bashkërendisim ekspertizën dhe entuziazmin e prindërve me iniciativa specifike të shkollës. Përmes organizimit të ligjeratave për fusha të ndryshme të



inkurajojmë nxënësitë të mësojnë për tema që dalin nga kurikullumi shkollor, por njëherit e plotësojnë programin mësimor. Për shembull, nxënësitë do të inkurajohen të shkruajnë për episođa të mësimiđ „learning episodes“ për temat e caktuara dhe ato të cilat marrim vlerësimin më të lartë (sipas kritereve të përcaktuara) do te shpërblehen. [temat të cilat mund të trajtohen janë: Cka është inteligjenca emocionale? Koncepti i ndërmarrësisë – si te jemi ndërmarrës të suksesshëm? Lidërshipi: dhunti apo aftësi e përfituar? Frika në teste/provime – a është shenjë e dobësisë? Si të shkruajmë një projekt propozim? Etj.]

Viti	Aktiviteti	Përgjegjësitë
2022/2023	<p>1. Harton planin trevjeçar të punës së Komitetit duke krijuar, në bashkëpunim me Shkollën databazën e aftësive/ekspertizës së prindërve, përmes së cilës do të bashkërendisim ekspertizën dhe entuziazmin e prindërve me iniciativa specifike të shkollës për organizim të ligjeratave me tema të ndryshme.</p> <p>2. Organizon së paku një aktivitet me Shkollën për tema që dalin nga kurikullumi shkollor, por njëherit e plotësojnë programin mësimor.</p>	Komiteti për Cilësi Akademiķe
2023/2024	<p>1. Organizon së paku një aktivitet me Shkollën për tema që dalin nga kurikullumi shkollor, por njëherit e plotësojnë programin mësimor.</p>	Komiteti për Cilësi Akademiķe
2024/2025	<p>1. Organizon së paku një aktivitet me Shkollën për tema që dalin nga kurikullumi shkollor, por njëherit e plotësojnë programin mësimor.</p>	Komiteti për Cilësi Akademiķe

Qëllimi i Pestë Strategjik: “Pozicionon KPSH si akter proaktiv për konsultim për politika të shkollës”

Progresi i deritanishëm: Kryesia e KPSH ka marrë pjesë në secilin takim që është ftuar nga Këshilli Drejtues i shkollës dhe ka kryer raportimin në KPSH.

Objektivi ynë është që KPSH të themeloj kanalën e komunikimit për konsultim të drejtëpërdrejtë me menaxhmentin e shkollës dhe përmes përfaqësimit në Këshillin Drejtues të shkollës.

Viti	Aktiviteti	Përgjegjësitë
2022/2023	Kryesia në bashkëpunim me KPSH-në harton tema me interes për prezentim dhe trajtim në Këshillin Drejtues të Shkollës; dhe raporton mbi to në KPSH.	Kryesia e KPSH-së
2023/2024	Kryesia në bashkëpunim me KPSH-në harton tema me interes për prezentim dhe trajtim në Këshillin Drejtues të Shkollës; dhe raporton mbi to në KPSH.	Kryesia e KPSH-së
2024/2025	Kryesia në bashkëpunim me KPSH-në harton tema me interes për prezentim dhe trajtim në Këshillin Drejtues të Shkollës; dhe raporton mbi to në KPSH.	Kryesia e KPSH-së